



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 7436 Prot.

Tiranë, më 4 02. 2022

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 11, datë 4 02 2022

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik" në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Harmonia" shpk, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim, në procedurën e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas" me vlerë 12.160.228 lekë pa Tvsh, të zhvilluar nga Bashkia Patos në datë 19.01.2021 dhe në procedurat e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugës "Kamines" (Hoxhenjtë) fshati Suk 1, 1040 ml" me vlerë 2.916.614 lekë pa Tvsh, "Rikonstruksion i rrugës "Hysni Toska" fshati Luar 350 ml" me vlerë 1.401.840 lekë pa Tvsh dhe "Rikonstruksion i rrugës lagjia fushë, fshati Kurjan 714 ml" me vlerë 2.611.901 lekë pa Tvsh, të zhvilluara nga Bashkia Roskovec në datë 12.02.2021 (zhvilluar në këtë datë tre procedurat e prokurimit).

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Harmonia" Shpk, me NIPT J62903480D, me adresë: Lagjia "Kastriot", Rr. "Leon Rei", Fier.

I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Harmonia" shpk, ka nisur, mbi bazën e informacionit të dërguar nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (në vijim "ISHPSHSH"), në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve tona, ku rezultonte, ndaj subjektit "Harmonia", pas inspektimeve të kryera nga ky institucion, janë marrë 2 (dy) masa administrative "gjobë", në shumën totale 780.000 lekë, për shkelje të legjislacionit të punës.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e nenit 78/1/a të LPP.

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 11, datë 4 02.2022, APP ka vendosur të përjashtojë për 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, operatorin ekonomik "Harmonia" Shpk, me NIPT J62903480D, nga e drejta për të fituar kontrata publike, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.